



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të nenit 73 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2016, për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna dhe nenit 71 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 02 shkurt 2017, miratoi,

VENDIM PËR THEMELIMIN E KOMITETEVE KONSULTATIVE

Neni 1

Themelohen Komitetet Konsultative, si në vijim:

- Komiteti për Zhvillim Ekonomik
- Komitetin për Shërbime Publike, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 2

Kuvendi, në propozim të Panelit përzgjedhës të cilin e ngritë paraprakisht, e miraton përbërjen e Komiteteve përkatëse nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe OJQ – ve.

Komitetet përbëhen prej 5 anëtarë.

Komitetet nga përbërja e tyre, me shumicë votash, e zgjedhin kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin.

Neni 3

Komitetet përbëhen nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe OJQ-ve dhe ngritën për mandat 4 vjeçar.

Punët dhe angazhimet në Komitete kompensohen, në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve obligative (50 €), më së shumti për gjashtë mbledhje gjatë një viti fiskal, nga kategoria e mjeteve buxhetore paga dhe mëditje - Programi i Kuvendit.

Neni 4

Kompetencat

- Japin propozime dhe sugjerime në propozim aktet e ndryshme normative.
- Japin mendime dhe ide lidhur me iniciativat e ndërmarra në fushat përkatëse nga Kryetari i Komunës, Kuvendit të Komunës dhe Komitetet e Kuvendit.
- Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës i paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme.
- Paraqesin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.
- Bëjnë hulumtime të ndryshme.

Neni 5

Përzgjedhja e anëtarëve të komiteteve bëhet përmes procedurës së konkursit publik.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Podujevës, nr.01-006-45858 i datës 27 maj 2014.

Neni 7

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

01-020/04-5988/17
Podujevë,
02 shkurt 2017



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi